



Ministrja Ekonomi, bashkëbisedim me studentët dhe pedagogët e UET



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi ishte e ftuar këtë javë nga Universiteti Europian i Tiranës ku, bashkë me studentët dhe pedagogët e UET, ndau mendime mbi raportin e fundit të Bankës Botërore “Doing Business 2017”, reformat e ndërmarra për të rimëkëmbur Shqipërinë dhe sfidat e ekonomisë shqiptare. Ministrja Ekonomi shprehu kënaqësinë që ishte e ftuar në një leksion në hapur në këtë Universitet, ftesë e cila përkonte edhe me 10 vjetorin e tij. Gjatë bashkëbisedimit, Ministrja Ekonomi inkurajoi studentët dhe akademikët e UET që përmes studimeve dhe mendimeve të bëhen pjesë e përpjekjeve për të fuqizuar ekonominë shqiptare. Ministrja e MZHETTS prezantoi fillimisht gjetjet dhe arritjet e Doing Business, i cili këtë vit e renditi Shqipërinë në një pozicion historik, në vendin e 58-të nga 190 shtete të vlerësuara, me një përmirësim prej 32 vendesh nga raporti i vitit të kaluar. Më pas, duke iu përgjigjur pyetjeve, Ministrja Ekonomi foli për reformat e ndërmarra, sektorët strategjikë e prioritarë ku do të fokusohet fokusohet vëmendja e qeverisë në vitet që vijnë, në funksion të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të vendit, si energjia, turizmi apo bujqësia. “Sektorët kryesorë që ne mendojmë se duhet të zhvillojë Shqipëria padyshim që janë sektori i energjisë, transportit dhe sektorët që sjellin produktivitet. Sektor tjetër i rëndësishëm që duhet të sjellë zhvillimin e ekonomisë sonë është padyshim sektori i turizmit, sepse Shqipëria ofron një diversitet të jashtëzakonshëm të destinacionit turistik”, - tha Ministrja Ekonomi. Në vijim, Ministrja diskutoi dhe iu përgjigji pyetjeve të shumta të studentëve dhe pedagogëve lidhur me zhvillimin e ekonomisë, lirinë ekonomike, monopolet në biznes, etj.

Nis puna për përmirësimet e mëtejshme në “Doing Business”



Në ambientet e MZHETTS u organizua takimi prezantues i gjetjeve të raportit “Të bësh biznes 2017”. Ky takim u drejtua nga Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi dhe morën pjesë ekspertë të Bankës Botërore dhe përfaqësues të grupit ndërinstitucional të punës. Ky takim u hap me falënderimin e ministres Ekonomi për grupin e Bankës Botërore, koordinatorët në MZHETTS dhe pikat e kontaktit nga të gjitha institucionet e përfshira, për kontributin e dhënë në përmirësimin e renditjes së Shqipërisë nëpërmjet reformave të ndërmarra, veçanërisht në fushën e lejeve të ndërtimit, marrjes së energjisë dhe pagesës së taksave. Përfaqësuesja e Bankës Botërore, pas prezantimit të indikatorëve të cilët janë vlerësuar pozitivisht këtë vit në raport, u ndal në mënyrë të veçantë tek reformat ku Shqipëria duhet të fokuset në 2017, që mund të ndikojnë në renditjen e vendit. Konkretisht për indikatorin e lejeve të ndërtimit, marrjen e energjisë, regjistrimin e pasurisë, zbatimin e kontratave, duhet të vijojë procesi i implementimit të masave të cilat janë parashikuar për tu zbatuar. Përfaqësuesit nga MZHETTS dhe DPT informuan ekspertin për përditësimin e informacionit sa i takon procedurave për indikatorin regjistrimi i biznesit dhe pagesa e taksave, të dhëna të cilat mund të reflektohen në rivlerësimin e raportit për vitin e ardhshëm.

Fluturimet direkte Hungari -Shqipëri nga Wizzair rrisin bashkëpunimin ekonomik dhe turistik



Shqipëria dhe Hungaria janë të gatshme të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik mes tyre, pasi nisja e fluturimeve direkte Hungari- Shqipëri dhe anasjelltas, nga kompania Wizzair, do t'i shërbejë këtij qëllimi. Ky ishte qëndrimi i përbashkët mes Ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi dhe z.Péter Szijjártó, ministër i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Hungarisë, gjatë takimit të zhvilluar në kuadër të Samitit 16 +1 të nivelit të lartë mes Kinës dhe vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, në Riga të Letonisë. Të dy ministrat, gjatë bashkëbisedimit, vunë re se shkëmbimet tregtare mes dy vendeve janë në rritje. Të dhënat për volumin e tregtisë në 2015 u rritën me 41% krahasuar me 2014. Ndërsa, në muajt e parë të 2016 shënohet një rritje me 26 %. Aktualisht në Shqipëri, tha Ministrja Ekonomi, operojnë 43 biznese hungareze, por ky numër duhet të rritet pasi Shqipëria është një vend plot mundësi në të bërit biznes. Ministrja Ekonomi e vlerësoi si një zhvillim të rëndësishëm hapjen e zyrës së përfaqësimit nga “National Trading House i Hungarisë” në Tiranë, me qëllim eksplorimin e mundësive të reja të tregut dhe nxitjen e tregtisë së jashtme ndërmjet Hungarisë dhe Shqipërisë. Nisjen e fluturimeve direkte Budapest-Tiranë , në tremujorin e parë të 2017, nga kompania Wizzair, ministrja Ekonomi e quajti një zhvillim të rëndësishëm për dy vendet, që do t'i shërbejë bashkëpunimit ekonomik dhe turistik me përfitime të ndërsjellta. Të dy ministrat ranë dakord që takimi i Tetorit 2016 në Budapest, ndërmjet bashkë-Kryetarëve të Komisionit të Përbashkët Ekonomik Shqipëri – Hungari, kryesuar nga Zëvendësministrja e MZHETTS, Adela Karapici dhe Magyar Levente, Sekretar Shteti në MPJT, të vazhdojë me një tjetër takim punë në Shkurt 2017.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/fluturimet-direkte-hungari-shqiperi-nga-wizzair-rrisin-bashkepunimin-ekonomik-dhe-turistik&page=1>

Librazhd – Zhvillimi i industrisë së pasurimit të kromit



Një tjetër lajm i mirë për ekonominë shqiptare që vjen nga Librazhdi. Zëvendësministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Adela Karapici, mori pjesë në inaugurimin e Fabrikës së Pasurimit të Kromit. Investimi është i kompanisë italiane North Group Mining. Vlera e investimit, në fazën e parë, është 1.2 milionë euro. Do të punësohen rreth 100 punëtorë, me synimin për tu zgjeruar në fazat e tjera të projektit. North Group Mining synon edhe ngritjen në Përrenjas të një impianti për hekur-nikelin.

Promovim i pronësisë intelektuale nga DPPM



Drejtorja e Përgjithshme e Patentave dhe Markave zhvilloi një leksion të hapur me studentët dhe pedagogët e Universitetit Metropolitan. Ky aktivitet kishte për qëllim përcjelljen e njohurive mbi pronësinë intelektuale dhe, në veçanti, atë industriale tek studentët. Lektore në këtë event ishin znj. Rezarta Rajta, e cila prezantoi mënyrën se si funksionon sistemi i pronësisë intelektuale dhe mënyrën e mbrojtjes të objekteve të pronësisë industriale në Shqipëri, markave tregtare, patentave për shpikjet, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, si dhe znj. Darian Suli, e cila bëri një shpjegim të bazës ligjore dhe procedurave të kundërshtimit të regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale nga mbajtësit e të drejtave. Në prezantime u sollën shembuj të objekteve të pronësisë industriale dhe raste të konflikteve mes tyre. Prezantimi u zhvillua në mënyrë interaktive, nëpërmjet pyetjeve përgjigjeve dhe diskutimeve të rasteve konkrete. Si gjithmonë, studentet dhe pedagogët në auditorët e universiteteve janë një nga target grupet më të përshtatshëm për zhvillimin e këtyre aktiviteteve, pasi ata shprehin shumë interes për të kuptuar sa më mirë pronësinë intelektuale. Ky është një aktivitet i shtuar për promovimin e Pronësisë Industriale.

DPM organizon seminarin me temë “Vendoja e shenjës shqiptare të konformitetit "C"”



Në datë 03.11.2016, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, u zhvillua seminari me temë: “Vendosja e shenjës shqiptare të Konformitetit “c” në produktet e para paketuara shqiptare”. Qëllimi i këtij seminari ishte njohja e biznesit me Udhëzimin e Ministrit të MZHETTS, Nr. 1897/1, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të para paketimeve me shenjë konformiteti”. Seminari u zhvillua me pjesëmarrje të gjerë të përfaqësuesve të bizneseve që paketojnë produkte të para paketuara sipas standardeve ndërkombëtare. Seminari u drejtua nën kujdesin e Përgjegjëses së Sektorit të Para paketimeve pranë DPM-së, znj. Valdete Buca. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, prej shume vitesh, ka punuar me përkushtim për të ofruar si shërbim miratimin dhe monitorimin e sistemit të kontrollit sasior duke vendosur në para paketime shenjën shqiptare “c” të konformitetit, duke rritur kështu besueshmërinë të konsumatori vendas. Përfaqësuesit e bizneseve treguan interes për vendosjen e shenjës shqiptare të konformitetit, pasi kjo sjell besueshmëri në deklarin e sasisë nominale të produktit, lehtëson tregtimin e produkteve të para paketuara, duke rritur kështu jo vetëm imazhin e biznesit të tyre, por duke hedhur në treg një produkt të konkurrueshëm me standardet europiane.

Gazetarja italiane, Francesca Masotti, reportazh për Dhërmiun: Perla e Shqipërisë



Gazetarja italiane, Francesca Masotti në blogun e njohur për promovimin e vendeve turistike “On the top of the world”, këtë herë ka zgjedhur Dhërmiun, një vend i mahnitshëm fshehur në Evropën Lindore, siç cilësohet në reportazhin e saj, për ta prezantuar. Një fshat i vogël në jug të Shqipërisë, mes Vlorës dhe Sarandës shtrihet Dhërmiu apo, siç e quajnë atë, “një pjesë të vogël e qiellit në tokë”. Kështu e nis shkrimin Masotti, ndërsa fton ndjekësit të planifikojnë në këtë vend pushimet e tyre të ardhshme, duke qenë se vera kaloi. Për të arritur në Dhërmi nga Vlora (si unë), shkruan ajo, ju duhet të merrni me qira një makinë . Pasi kaloni maloren e Llogarasë, Dhërmiu është plazhi i dytë më i madh që do të hasni kësaj rruge. “Rruga dhe pamja përreth do t’ju lënë të pagojë. Kam udhëtuar nëpër të gjithë Evropën dhe kam parë shumë vende të bukura, por unë me siguri mund të them se Dhërmiu ka pamjen më të bukur që kam parë ndonjëherë”, - përshkruan Masotti. Dhërmiu, thotë ajo, është një destinacion madhështor. “Besomëni mua”, ju drejtohet ajo ndjekësve të saj. Nëse ju jeni në kërkim të pamjeve të mahnitshme, detit blu dhe plazheve të bukur, sipas Masottit, nuk ka vend më të mirë për të shkuar në Evropë. Deti Jon është i mahnitshëm. Këtu ju mund të zgjidhni mes plazheve shkëmbore dhe atyre ranore. Të dy janë të mrekullueshëm. Noti në këto ujëra blu të qarta është i paçmuar!”, shkruan gazetarja italiane.


<https://onthetopoftheworldblog.wordpress.com/tag/dhermi/>

75 arsye për të udhëtuar në Shqipëri. Menjëherë!



Jo dhjetë arsye por 75, ka renditur Allison Green, e lindur në Kaliforni por e pasionuar pas udhëtimeve. Kësaj radhe ajo i ka kushtuar një shkrim të detajuar për Shqipërinë dhe publikuar në faqen <http://eternalarrival.com/albania/75-reasons-travel-albania-asap/>. Më poshtë gjeni, një pjesë nga shkrimi i Allison Green, i shoqëruar me foto nga vende dhe pika të ndryshme turistike të vendit tonë: “Për një kohë të gjatë, Shqipëria ka qenë injoruar si destinacion turistik. E kuptoj. Vendi i është dashur të ringrihet. Për vite me radhë, Shqipëria ishte nën një prej regjimeve komuniste totalitare më shtypës në historinë – edhe Koreja e Veriut ka më shumë partnerë tregtarë dhe diplomaci, se sa Shqipëria tridhjetë vjet më parë. Ajo doli nga prangat e totalitarizmit në vitin 1991, praktikisht pa PBB pa një ekonomi. Një skemë piramidale në mbarë vendin, ku shqiptarët humbën një total prej 1.2 miliardë dollarë (një pasuri e vërtetë, po të kesh parasysh që shqiptarët kishin pasur vetëm gjashtë vjet treg të lirë) në vitin 1997 e zhyti vendin në kaos. Por gjërat janë shumë, shumë ndryshe tani, dhe ndërsa vendi ka ende shumë rrugë për të bërë, që të arrijë fqinjët e vet në Evropë, ai është duke bërë hapa të mëdha në drejtim të progresit të qëndrueshëm. Shqipëria është një vend me një histori të gjatë, gati 5000 vite, me ndikim të fortë nga ilirët, grekët, romakët, venedikasit, bizantinët dhe osmanët. Është miopi ta përmbledhësh Shqipërinë, si vetëm atë që ka ndodhur gjatë shekullit të fundit. Po, Shqipëria ka vuajtur, por ajo po ringrihet me një forcë të pabesueshme, dhe po rishfaqet me të drejtë si një destinacion turistik.

<http://eternalarrival.com/albania/75-reasons-travel-albania-asap/>



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania

Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55

E-mail: zmp@ekonomia.gov.al

Web: www.ekonomia.gov.al

